

VENDIM
Nr. 166, datë 10.10.2016

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR LIDHJET E REJA NË SISTEMIN E SHPËRNDARJES”

Në mbështetje të nenit 16, neni 20, germa “a”; nenit 27, pika 3; nenit 108, pika 3; nenit 110, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike,” si dhe nenit 26 të rregullores “Mbi organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016, të ERE-s, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 10.10.2016, pasi shqyrtoi relacionin për miratimin e rregullores “Për lidhjet e reja në sistemin e shpërndarjes”, të përgatitur nga drejtoritë teknike;

konstatoi se:

1. Me vendimin nr. 60, datë 29.4.2016, Bordi i ERE-s vendosi: “Fillimin e procedurave për shqyrtimin e draftrregullores “Për lidhjet e reja në sistemin e shpërndarjes.”

2. Me shkresën nr.350 prot, datë 3.5.2016, “Lidhur me draftet e akteve nënligjore në proces miratimi nga ERE”, Enti Rregullator i Energjisë i ka dërguar për mendim, palëve të interesuara draftin e rregullores “Për lidhjet e reja në sistemin e shpërndarjes.”

3. Me shkresën nr. 350/4, datë 26.5.2016, të MZHETTS-së është shprehur parimisht dakord dhe ka paraqitur disa komente përkatëse lidhur me draftrregulloren “Për lidhjet e reja në sistemin e shpërndarjes”, të cilat janë reflektuar në rregullore.

4. Në shkresën me nr. 350/1, datë 20.5.2016, Inspektorati Shtetëror Teknike dhe Industrial, pranë MEI-t, ka shprehur dakordësinë e tij lidhur me draftrregulloren, duke parashtruar dhe disa komente përkatëse, të cilat u reflektuan në rregullore.

5. Në shkresën me nr. 350/2, datë 23.5.2016, Ministria e Energjisë dhe Industrisë është shprehur parimisht dakord me draftrregulloren “Për lidhjet e reja në sistemin e shpërndarjes”, duke mos shtuar asnjë koment.

6. Me shkresën nr. 350/8 prot., datë 26.7.2016, ERE i ka dërguar palëve të interesuara një draft të përmirësuar të rregullores “Për lidhjet e reja në sistemin e shpërndarjes së energjisë elektrike”, i propozuar nga shoqëria “OSHEE” sh.a.

7. Në shkresën me nr. 281/1 prot., datë 8.8.2016, Autoriteti i Konkurrencës, ka shprehur qëndrimin e tij, i cili është reflektuar në rregullore.

8. Në shkresën me nr. 228/1 prot., datë 29.7.2016, Avokati i Popullit, ka shprehur qëndrimin e tij lidhur me rregulloren, i cili është reflektuar në rregullore.

9. Me shkresën nr. 6101 prot, datë 3.8.2016, MZHETTS-ja është shprehur parimisht dakord me rregulloren.

10. Me shkresën nr. 7425/1 prot., datë 5.8.2016, Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI) ka shprehur qëndrimin e tij, i cili është reflektuar në rregullore.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë rregulloren “Për lidhjet e reja me sistemin e shpërndarjes”, së bashku me anekset përkatëse (tarifat për lidhjet e reja dhe marrëveshja e lidhjes së re).

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorëve të njoftojë palët e interesuara për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

RREGULLORE
PËR LIDHJET E REJA NË SISTEMIN
E SHPËRNDARJES

PJESA I
KËRKESA TË PËRGJITHSHME

1.1 Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregulloreje është rregullimi i marrëdhënieve ndërmjet Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes OSSH dhe Përdoruesve të Sistemit të Shpërndarjes, të cilët kërkojnë të realizojnë një lidhje të re ose të modifikojnë lidhjet e tyre ekzistuese në Sistemin e Shpërndarjes, të përcaktojnë procedurat, afatet dhe tarifat për kryerjen e këtij shërbimi nga ana e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes si dhe të realizojë një unifikim të cilësisë së punimeve, standardeve dhe karakteristikave teknike të lidhjeve të reja në rrjetin e shpërndarjes së energjisë elektrike.

1.2 Autoriteti

Kjo rregullore hartohet bazuar në:

a) Ligjin nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”

b) “Kodin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike”

“Metodologjinë e llogaritjes së tarifës së shpërndarjes së energjisë elektrike”

1.3 Përkufizime

Aplikanti është pala e interesuar që ka aplikuar ose është në proces aplikimi për lidhje të re, modifikim apo rritje të kapacitetit të lidhjes ekzistuese, në rrjetin e OSSH-së.

Aplikim për lidhje është kërkesa për lidhje nga aplikanti për lidhje të re, modifikim të lidhjes ekzistuese, përfshirë dhe rritjen e kapacitetit të lidhjes së vjetër, në rrjetin e OSSH-së.

Tarifa për aplikim (pagesa) është pagesa që kryhet nga aplikanti në kohën kur aplikohet për lidhje, e cila mbulon studimin e pranueshmërisë së lidhjes në rrjetin e Shpërndarjes dhe përgatitjen e dokumentacionit për hartimin e marrëveshjes së lidhjes.

Formati i aplikimit për lidhje janë formate tip për çdo lloj lidhje sipas nivelit të tensionit.

Kapaciteti i lidhjes nënkupton fuqinë e plotë elektrike në MVA të ofruar për lidhje të re ose për rritje kapaciteti të lidhjes ekzistuese.

Data e lidhjes është data në të cilën asetet për lidhje janë apo konsiderohen të jenë plotësisht të lidhura në rrjetin e OSSH-së dhe që vetë OSSH-ja është në gjendje të sigurojë kapacitetin për lidhje.

Oferta për lidhje është një ofertë për lidhje në rrjetin e OSSH-së e dhënë sipas afateve të përcaktuara në këtë rregullore.

Pala përgjegjëse për lidhje është pala që mund të jetë aplikanti ose/dhe OSSH-ja që merr përgjegjësinë për procesin e projektimit, tenderimit, ndërtimit, testimit dhe energjizimit të një lidhjeje.

Asetet e lidhjes janë asetet që përfshijnë pasurinë e luajtshme (pajisjet) dhe pasurinë e paluajtshme (ndërtesat).

Tarifa për mbikëqyrje dhe tarifa për kolaudim janë tarifa për kontrollin dhe vlerësimin e projektit teknik, mbikëqyrjen e ndërtimit, testimit dhe kolaudimit të lidhjes, të cilat paguhen nga aplikanti.

Përdoruesi i sistemit ose përdoruesi është i lidhuri në Sistemin e Shpërndarjes duke qenë konsumator i lidhur direkt, gjenerues.

Lidhja e re është linjë furnizimi TM, TU, kabinë transformacioni, pajisje të lidhura në rrjetin e Shpërndarjes në pikën/nyjën lidhëse, e përcaktuar me kVA ose MVA, në nivelin nominal të tensionit.

Pika e lidhjes është pika e lidhjes fizike të një përdoruesi me rrjetin e shpërndarjes.

Pika e dorëzimit është ambienti i instalimit të pajisjeve komutuese të magjstralit TM.

Pika e matjes është vendi fizik ku është realizuar pika e lidhjes dhe ku sistemi i matjes plotëson të gjitha kushtet teknike dhe të saktësisë sipas Kodit të Matjes. Pika fizike e matjes përcaktohet plotësisht nga marrëveshjet midis Palëve.

Ambienti i matjes është vendi fizik në të cilin realizohet matja e energjisë elektrike.

Ambienti i klientit është vendi fizik ku vendoset tërësia e pajisjeve elektrike të transformimit, që i shërben klientit për furnizimin me energji elektrike të objektit të tij.

1.4 Garantimi i lidhjes në rrjetin e shpërndarjes

OSSH-ja do të sigurojë lidhjen në rrjetin e shpërndarjes të gjithë palëve të interesuara në përputhje me ligjin nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe me kriteret e përcaktuara në këtë rregullore.

1.5 Personat që kanë të drejtë të aplikojnë

Aplikimi për lidhje të re në sistemin e shpërndarjes mund të kryhet nga:

a) Çdo person fizik apo juridik, i cili aplikon për realizimin e një lidhje të re në sistemin e shpërndarjes së energjisë elektrike (aplikanti), në përputhje me detyrimet e përcaktuara në aktmarrëveshjen ndërmjet përdoruesit dhe OSSH-së.

b) Përdoruesit ekzistues të sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike, të cilët kërkojnë të realizojnë një lidhje të re ose të modifikojnë lidhjet e tyre ekzistuese në sistemin e shpërndarjes (përdoruesi).

c) Operatori i Sistemit të Shpërndarjes nuk do të miratojë kërkesën për lidhje të re, nëse përdoruesi apo Aplikanti nuk ka plotësuar të gjitha kushtet teknike dhe standardet si detyrim për zbatimin e kodeve dhe rregullave në fuqi ose kur rezulton debitor dhe nuk ka shlyer detyrimet e mëparshme ndaj Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes.

1.6 Kërkesa për lidhje të re

Kërkesa për lidhje të re paraqitet pranë zyrave të OSSH-së, për:

a) Lidhje të objekteve (banimi apo biznesi) me rrjetin elektrik të sistemit të shpërndarjes;

b) Rritjen e fuqisë së lidhjes ekzistuese;

c) Kërkesë për lidhje të përkohshme;

d) Lidhje në sistemin e shpërndarjes të burimeve gjeneruese.

1.7 Kriteret për vlerësimin e lidhjes së re apo modifikimin e lidhjes ekzistuese

Operatori i Sistemit të Shpërndarjes për vlerësimin e një aplikimi për lidhje të re apo modifikim të një lidhjeje ekzistuese do të respektojë kërkesat e:

1. Ligjit për garantimin e sigurisë së punës së pajisjeve dhe të instalimeve elektrike;

2. Rregullat teknike të përcaktuara në vendimet përkatëse të Këshillit të Ministrave;

3. Kushtet dhe rregullat e përcaktuara në Kodin e Shpërndarjes dhe Kodin e Matjes, si dhe kriteret si vijon:

a) vendndodhjen e objektit për të cilin kërkohet lidhja, të plotësohet me koordinatat e konturit të sipërfaqes së tij;

b) distancën e objektit me pikën e lidhjes;

c) rrjetin shpërndarës të OSSH-së;

d) sigurinë e furnizimit me energji elektrike;

e) nivelet e rrymave të lidhjes së shkurtër, parametrat teknik, seksioni standard, IP, rryma e lidhjes së shkurtër, koha e veprimit të mbrojtjes;

f) të gjitha aplikimet e tjera për lidhje në të njëjtën pikë të rrjetit të shpërndarjes të OSSH-së.

Lidhjet e reja apo modifikimet e lidhjes ekzistuese nuk duhet të shkaktojnë efekte negative mbi klientët apo përdoruesit ekzistues dhe as nuk duhet të ndikohen nga efektet negative të klientëve apo përdoruesve ekzistues. Njëkohësisht ajo nuk duhet të shkaktojë efekte negative në rrjetin shpërndarës të OSSH-së, por do të respektojë standardin ISO 18001.

Operatori i Sistemit të Shpërndarjes do të përcaktojë kushtet dhe mënyrën e realizimit të lidhjes së re si dhe parametrat teknik të pajisjeve që do të shërbejnë për lidhjen e klientëve të rinj me Sistemin e Shpërndarjes konform:

- standardeve të harmonizuara shqiptare (neni 34, i ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”);

- standardeve evropiane;

- standardeve të vetë shoqërisë OSSH;

- rregullave teknike dhe ligjin për garantimin e sigurisë së punës së pajisjeve dhe të instalimeve elektrike.

1.8 Leja për hyrjen në objekt

Përdoruesit apo aplikantët që paraqesin kërkesën për lidhje të re kanë detyrimin që t'i sigurojnë Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) të drejtën për të hyrë në objektet e tyre, duke i krijuar lehtësira të nevojshme, në mënyrë që ky i fundit të arrijë të vlerësojë të gjitha kërkesat dhe kushtet për lidhjen e re.

1.9 Kërkesat teknike për një lidhje të re

Të gjitha punimet për realizimin e lidhjes së re në rrjetin shpërndarës të OSSH-së do të bëhen nga Aplikanti, mbi bazë të akt-marrëveshjeve dypalëshe me Operatorin e Shpërndarjes. Aplikanti duhet të respektojë:

a) të gjitha standardet e cilësisë së materialeve sipas normave evropiane të përcaktuara nga Operatori i Shpërndarjes

b) karakteristikat teknike sipas normave të përcaktuara nga Operatori i Shpërndarjes

c) seksionet e kabllave dhe rrymat e LSH-së të pajisjeve komutuese, të përcaktuara nga Operatori i Shpërndarjes

d) nivelin e humbjeve për pajisjet transformuese të furnizimit me energji elektrike të objektit të tij, në mënyrë që t'i përgjigjen zhvillimeve të rrjetit shpërndarës edhe në të ardhmen, si dhe arkitekturën e komunikimit të pajisjeve digjitale me sistemin e Operatorit të Shpërndarjes, të përcaktuara nga Operatori i Shpërndarjes

e) kontrollin e pajisjeve nga laboratorë të tretë, të akredituar sipas standardeve të EU-së

f) të gjitha normat e sigurimit teknik në përputhje me standardin ISO 18001 dhe të ligjeve, akteve nënligjore dhe rregullave në fuqi.

Të gjitha punimet me karakter ndërtimor, linjat e furnizimit me energji elektrike dhe pajisjet kryesore të kabinave elektrike (çelat hyrëse /dalëse, çelat e transformatorëve, trans-formatorët e fuqisë, panelet e shpërndarjes së tensionit të ulët, panelet e matjes TM/TU, kabllot lidhëse me rrjetin e tensionit të mesëm dhe të ulët etj.), do të:

a) kryhen nga aplikanti sipas direktivave të dhëna në studimin e pikës së lidhjes nga OSSH-ja. Projektet duhet të realizohen nga inxhinierë të licencuar duke respektuar kriteret në aneksin 1

b) zgjidhen në bazë të standardeve dhe kërkesave të përcaktuara nga Operatori i Shpërndarjes dhe në përputhshmëri me një akt-marrëveshje dypalëshe, të mundësohet kontrolli i tyre nga laboratorë të tretë, të akredituar nga EU-ja.

c) instalohen në përputhje me kërkesat dhe kushtet teknike të OSSH-së

d) testohen nga aplikanti në përputhje me të gjitha protokollet dhe detyrimet ligjore në fuqi dhe do të jenë konform standardeve teknike të cilat janë pjesë e marrëveshjes së lidhjes së re.

e) mbikëqyren dhe kolaudohen nga OSSH-ja.

1.10 Përgjegjësia e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes

Operatori i Sistemit të Shpërndarjes është përgjegjës, për:

a) Përgatitjen e kushteve teknike të lidhjes së re dhe specifikimet teknike të të gjitha pajisjeve që mund të përfshihen në realizimin e lidhjes së re.

b) Përgatitjen e kostove respektive për çdo mundësi të realizimit të lidhjes së re, nëse aplikanti e dëshiron si operator ekonomik, për realizimin e instalimit të lidhjes së re të realizuar nga ai.

c) Në zbatim të nenit 27, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", OSSH-ja, në çdo rast, përcakton kriteret dhe kushtet teknike që duhet të plotësohen për lidhjen me rrjetin, pavarësisht përzgjedhjes nga ana e aplikantit të operatorit të licencuar nga organet kompetente, që do të realizojë punimet e lidhjes.

1.11 Përgjegjësia e instalimeve të brendshme elektrike të objektit të aplikuesit.

a) Përdoruesi apo aplikanti, i cili do të furnizohet me energji elektrike nëpërmjet lidhjes së re që kërkohet të realizohet, është përgjegjës për instalimin:

- e të gjitha pajisjeve mbrojtëse nga lidhja e shkurtër;

- e pajisjeve të mbrojtjes nga lidhja me tokën;

- e pajisjeve të mbrojtjes nga mbitensionet (atmosferike, ato të komutimit dhe ato të mbrojtjes nga këputja e përcjellësit të neutralit).

b) Përdoruesi apo aplikanti do të realizojë sistemin e tokëzimit të objektit dhe klientëve të tjerë, të cilët furnizohen me energji elektrike nga kjo lidhje e re, në përputhje me kushtet teknike dhe normat në fuqi.

c) Përdoruesi apo aplikanti do të garantojë se të gjitha instalimet elektrike në të gjithë objektin që kërkohet të furnizohet me energji elektrike janë kryer, inspektuar dhe provuar nga një subjekt i pajisur me licencë për projektimin dhe instalimin e pajisjeve elektrike në përputhje me rregullat dhe kushtet teknike në fuqi.

d) Për asnjë aplikant apo përdorues nuk do dalë urdhri i dhënies së tensionit, nëse instalimet e brendshme nuk do të kenë mbrojtjet e përcaktuara në këtë paragraf.

e) Përdoruesi apo aplikanti do të marrë përsipër të çliroj nga çdo lloj përgjegjësie Operatorin e Sistemit të

Shpërndarjes, për çdo lloj detyrimi që lidhet me dëmtime të çdo lloji të rrjetit shpërndarës, të shkaktuara prej instalimeve të brendshme të pajisjeve elektrike në objektin që kërkohet të lidhet me energji elektrike.

1.12 Mënyra e komunikimit

Si formë komunikimi do të jetë ajo me shkresë zyrtare e shoqëruar me numrin respektiv të protokollit. Gjatë hapave të ndryshëm të zbatimit të procedurave mund të pranohet edhe komunikimi me e-mail midis palëve për efekt të shkëmbimit vetëm të njoftimeve për përfundimin e disa hapave konkrete, sikurse janë të përcaktuar në këtë rregullore.

1.13 Mënyra e aplikimit

Aplikimi për lidhjen e re do të bëhet sipas formularit tip të aplikimit dhe do të kryhet:

1) Për fuqi të instaluar nga 0-20 kW - pranë zyrave të kujdesit të klientit të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, në zonën e banimit të aplikantit.

2) Për fuqi të instaluar nga 21 deri në 50 kW:

- Për lidhjet në TU - pranë zyrave të kujdesit të klientit të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, në zonën e banimit të aplikantit.

- Për lidhjet në TM - pranë zyrës së kujdesit të klientit të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, në zonën e vendndodhjes së objektit.

3) Për fuqi të instaluar më shumë se 50 kW - pranë zyrave të Kujdesit të Klientit të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, në zonën e vendndodhjes së objektit.

Detajet e vendndodhjes së zyrave të kujdesit ndaj klientit, informacion mbi formularin tip që do të përdoret për të aplikuar për lidhje të re si edhe dokumentacionin e plotë që lidhet me kërkesat dhe kushtet teknike që duhet të respektohen për të projektuar dhe realizuar lidhjen e re në çdo rreth, mund të gjenden në adresën përkatëse të internetit të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes.

1.14 Kërkesa për furnizim me energji elektrike nga dy burime të pavarura

1. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes do të vlerësojë kërkesën për lidhje të re me energji elektrike të objektit nga dy burime të pavarura të energjisë elektrike, në përputhje me Rregullat e Shfrytëzimit dhe Operimit të Sistemit të Shpërndarjes në zbatim të Kodit të Shpërndarjes.

2. Tarifat respektive për këto raste paraqiten në pjesën IV të kësaj rregulloreje.

PJESA II

DOKUMENTACIONI I KËRKUAR PËR APLIKIMIN E NJË LIDHJE TË RE.

Për Lidhje të reja në TU

2.1 Fuqia e instaluar 0-20 kW

Aplikanti duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Kërkesë për furnizimin me energji elektrike

2. Vërtetimi i identitetit (fotokopje karte identiteti ose pasaporte)

3. Vërtetim i pronësisë së objektit nëpërmjet dokumenteve të regjistrimit të pronësisë, si: akt shitje, akt dhurimi, akt ndarje prone të patundshme, kontratë qiraje, dokumentacioni përkatës për objektet që janë në proces legalizimi)

4. Fotokopje e Certifikatës së regjistrimit (për subjektet jofamiljare)

5. Genplani i vendndodhjes së objektit në shkallën 1:1000 (dy kopje), (të specifikuar koordinatat e konturit të sipërfaqes së objektit).

6. Deklaratë instalimi dhe protokoll tokëzimi, i lëshuar nga inxhinier elektrik i pajisur me licencë.

2.2. Fuqia e instaluar 20-50 kW

Aplikanti duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Kërkesë për furnizimin me energji elektrike.

2. Vërtetimi i identitetit (fotokopje karte identiteti ose pasaporte).

3. Vërtetim i pronësisë së objektit nëpërmjet dokumenteve të regjistrimit të pronësisë, si: akt shitje, akt dhurimi, akt ndarje prone të patundshme, kontratë qiraje, dokumentacioni përkatës për objektet që janë në proces legalizimi).

4. Fotokopje e certifikatës së regjistrimit (për subjektet jofamiljare).

5. Projekti elektrik i objektit, i miratuar nga organet kompetente sipas legjislacionit në fuqi.

6. Planvendosja e të gjitha pajisjeve në objekt.

7. Licenca e inxhinierit elektrik, i cili ka bërë projektin elektrik të objektit.

8. Genplani i vendndodhjes së objektit në shkallën 1:1000 (dy kopje), (të specifikuara koordinatat e gjurmës së objektit).

9. Deklaratë instalimi dhe protokoll tokëzimi, i lëshuar nga inxhinier elektrik i pajisur me licencë.

10. Raporti i detajuar inxhinierik në lidhje me projektin dhe përlogaritjen e të dhënave, i kryer nga inxhinier elektrik i pajisur me licencë.

2.3 Fuqia e instaluar 50 - 100 kW

Aplikanti duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Kërkesë për furnizimin me energji elektrike.

2. Vërtetimi i identitetit (fotokopje karte identiteti ose pasaporte).

3. Vërtetim i pronësisë së objektit nëpërmjet dokumenteve të regjistrimit të pronësisë, si: akt shitje, akt dhurimi, akt ndarje prone të patundshme, kontratë qiraje, dokumentacioni përkatës për objektet që janë në proces legalizimi).

4. Fotokopje e certifikatës së regjistrimit (për subjektet jofamiljare).

5. Projekti elektrik i objektit, i miratuar nga organet kompetente sipas legjislacionit në fuqi.

6. Planvendosja e të gjitha pajisjeve në objekt.

7. Licenca e inxhinierit elektrik, i cili ka bërë projektin elektrik të objektit.

8. Genplani i vendndodhjes së objektit në shkallën 1:1000 (dy kopje), (të specifikuara koordinatat e gjurmës së objektit).

9. Deklaratë instalimi dhe protokoll tokëzimi, i lëshuar nga inxhinier elektrik i pajisur me licencë.

10. Raporti i detajuar inxhinierik në lidhje me projektin dhe përlogaritjen e të dhënave, i kryer nga inxhinier elektrik i pajisur me licencë.

11. Leja e ndërtimit të objektit

12. Grafiku i ngarkesës elektrike

13. Relacion analitik për vlerësimin e $\cos\phi$

Për lidhje të reja në TM

Aplikanti duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Kërkesë për furnizimin me energji elektrike

2. Vërtetimi i identitetit (fotokopje karte identiteti ose pasaporte)

3. Vërtetim i pronësisë së objektit nëpërmjet dokumenteve të regjistrimit të pronësisë, si: akt shitje, akt dhurimi, akt ndarje prone të patundshme.

4. Fotokopje e certifikatës së regjistrimit (për subjektet jofamiljare).

5. Projekti elektrik i objektit, i miratuar nga organet kompetente sipas legjislacionit në fuqi.

6. Planvendosja e të gjitha pajisjeve në objekt.

7. Licenca e inxhinierit elektrik, i cili ka bërë projektin elektrik të objektit.

8. Genplani i vendndodhjes së objektit në shkallën 1:1000 (dy kopje), (të specifikuara koordinatat e gjurmës së objektit).

9. Deklaratë instalimi dhe protokoll tokëzimi, i lëshuar nga inxhinier elektrik i pajisur me licencë.

10. Raporti i detajuar inxhinierik në lidhje me projektin dhe përlogaritjen e të dhënave, i kryer nga inxhinier elektrik i pajisur me licencë.

11. Leja e ndërtimit të objektit.

12. Grafiku i ngarkesës elektrike.

13. Relacion analitik për vlerësimin e $\cos\phi$.

PJESA III

PROCEDURAT E APLIKIMIT PËR NJË LIDHJE TË RE.

3.1 Procedurat dhe afatet kohore për lidhje të re ose për modifikim të një lidhjeje ekzistuese në tension të ulët.

3.1.1 Procedurat dhe afatet kohore për lidhje të re ose për modifikim të një lidhjeje ekzistuese në tension të ulët për fuqi të instaluar 0 - 20 kW.

a) Aplikanti bën kërkesën dhe paraqet dokumentacionin pranë zyrave të kujdesit ndaj klientit të OSSH-së.

- Afati i realizimit të lidhjes së re për këto raste do të jetë:

- i) jo më shumë se 20 ditë pune për fuqi të instaluar deri në 10 kw
- ii) jo më shumë se 20 ditë pune për fuqi të instaluar 10-20 kw
- b) Operatori i Sistemit të Shpërndarjes do të inspektojë objektin që kërkon lidhjen me energji elektrike dhe do të kryejë miratimin e pikës dhe menyrës së lidhjes në rrjet.
- c) Llogarit kostot për lidhjen e re.
- d) Pas kryerjes nga aplikanti të pagesës së tarifës së lidhjes së re, OSSH zbaton të gjitha procedurat deri në furnizimin me energji elektrike të objektit.
- e) Lidhja me tension dhe furnizimi me energji elektrike do të realizohet në të njëjtën kohë me vendosjen e aparatit matës.
- f) Operatori i Sistemit të Shpërndarjes regjistron lidhjen e re ose modifikimin e kryer për aplikantin/klientin apo përdoruesin në sistemin e tij të klientëve dhe përgatit kartelën e furnizimit të tij, brenda 3 ditëve pune pas vënies në tension. Operatori i Sistemit vë në dispozicion të aplikantit informacionin e nevojshëm për lidhjen e re ose modifikimin e lidhjes së kryer.
- g) Verifikimi i matësit të energjisë elektrike realizohet nga subjekti i pavarur, i autorizuar për verifikimin e matësve të energjisë elektrike, sipas parashikimeve të bëra në ligjin nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike". Test raporti i verifikimit të matësit elektrik dorëzohet nga subjekti i pavarur te klienti dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes.

h) I gjithë informacioni i lidhjes së re ruhet nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes në mënyrë elektronike dhe dokumentare.

3.1.2 Procedurat dhe afatet kohore për lidhje të re ose për modifikim të një lidhjeje ekzistuese kur fuqia e instaluar është 21-50 kW në TU.

a) Për rastet kur fuqia e instaluar për një lidhje të re ose për modifikimin e një lidhjeje ekzistuese, është 21-50 kW, në tension të ulët, procedurat dhe afatet kohore do të jenë të njëjta me ato të përcaktuara në pikën 3.1.1 (pika a-d).

b) Lidhja nën tension dhe furnizimi me energji elektrike do të realizohet nga OSSH-ja me anë të zbatimit të urdhrit të dhënies tension.

c) Në rast se gjatë vënies në tension të objektit, lindin probleme në pajisjet që realizuan lidhjen, atëherë Aplikanti është i detyruar, me shpenzimet e tij, të riparojë pjesën e dëmtuar ose jo funksionale deri sa skema e plotë të funksionojë normalisht, si dhe të paguajë dëmin e shkaktuar.

d) Operatori i Sistemit të Shpërndarjes regjistron përdoruesin apo aplikantin në sistemin e tij të klientëve dhe përgatit kartelën e furnizimit të tij/tyre brenda 2 ditëve pune pas vënies nën tension. Operatori i Sistemit vë në dispozicion të aplikantit, informacionin e nevojshëm për lidhjen e re ose modifikimin e lidhjes së kryer dhe furnizuesi çdo muaj duhet të kryejë rakordimin me Operatorin e Shpërndarjes.

e) Verifikimi i matësit të energjisë elektrike realizohet nga subjekti i pavarur, i autorizuar për verifikimin e matësve të energjisë elektrike, sipas parashikimeve të bëra në ligjin nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike". Test raporti i verifikimit të matësit elektrik dorëzohet nga subjekti i pavarur te klienti dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes.

f) I gjithë informacioni i lidhjes së re ruhet nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes në mënyrë elektronike dhe dokumentare.

3.1.3 Procedurat dhe afatet kohore për lidhje të re ose për modifikim të një lidhjeje ekzistuese kur fuqia e instaluar është 50-100 kW në TU.

a) Përdoruesi apo aplikanti duhet të paraqesë projektin elektrik të objektit që kërkohet të furnizohet me energji elektrike. Ky projekt do të jetë në përputhje me legjislacionin në fuqi, të ketë/të pasqyrojë të gjitha detajet konstruktive dhe mënyrën e realizimit të instalimeve të brendshme të tij duke u shoqëruar me relacionin teknik përkatës për të treguar të gjitha ngarkesat elektrike dhe mënyrën e vendosjes së tyre brenda objektit. Projekti do të respektojë kushtet teknike të lidhjes së re që janë pjesë e kësaj rregullore. Ky projekt do të jetë i realizuar dhe përlogaritur nga një inxhinier i licencuar ose kompani e licencuar për projekte elektrike.

b) Periudha e vlerësimit prej Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes të kërkesës së bërë nga përdoruesi apo aplikanti dhe paraqitja për pranim dhe nënshkrimi i propozimit për lidhjen e "Marrëveshjes së lidhjes së re" nuk do të jetë më shumë se 20 ditë pune prej ditës së paraqitjes së aplikimit.

c) Operatori i Sistemit të Shpërndarjes do të kryejë paraprakisht verifikimin e dokumentacionit të paraqitur nga përdoruesi apo aplikanti dhe nëse aplikimi nuk është i plotë, atëherë Operatori i Sistemit të Shpërndarjes do të njoftojë përdoruesin apo aplikantin me shkrim brenda 5 ditëve pune që nga data kur

aplikimi është dorëzuar për vlerësim.

d) Operatori i Sistemit të Shpërndarjes do të inspektojë objektin që kërkon lidhjen me energji elektrike dhe në varësi të gjendjes së rrjetit elektrik në atë zonë, do të përgatisë mënyrën e lidhjes së objektit në rrjet. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes do të përgatisë propozimin dhe marrëveshjen për lidhjen e re dhe do t'ia dërgojë aplikantit për pranim sipas afateve të pikës 3.1.3/b.

e) Propozimi për lidhjen e re, i përgatitur nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes mund të pranohet nga aplikanti jo më vonë se 5 (pesë) ditë pune nga data që Operatori i Sistemit të Shpërndarjes e ka vendosur propozimin e tij në dispozicion të aplikantit.

f) Nëse aplikanti e pranon propozimin atëherë aplikanti do të paguajë detyrimet përkatëse brenda 5 ditëve pune nga njoftimi i propozimit të bërë, përndryshe propozimi bëhet i pavlefshëm dhe ai duhet të aplikojë përsëri për lidhje të re.

g) Llogarit kostot për lidhjen e re.

h) Pas kryerjes nga aplikanti të pagesës së tarifës së lidhjes së re, shlyerjes së detyrimeve të tjera dhe inspektimit brenda 3 ditëve pune nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, përgatitet urdhri për zbatimin e lidhjes së re. Sistemi i matjes së energjisë duhet të instalohet brenda 5 ditëve pune nga dita e nxjerrjes së raportit të instalimit të matjes për lidhjen në TU dhe 10 ditëve pune për lidhjen në TM. Lidhja nën tension dhe furnizimi me energji elektrike do të realizohet nga OSSH-ja me anë të zbatimit të urdhrit të dhënies tension.

i) Verifikimi i matësit të energjisë elektrike realizohet nga subjekti i pavarur, i autorizuar për verifikimin e matësve të energjisë elektrike, sipas parashikimeve të bëra në ligjin nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike". Test raporti i verifikimit të matësit elektrik i dorëzohet nga subjekti i pavarur te klienti dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes.

j) Pajisjet e lidhjes së re sigurohen, instalohen dhe testohen nga vetë aplikanti.

k) Në rast se gjatë vënies në tension të objektit lindin probleme në pajisjet që realizuan lidhjen, të instaluar nga aplikanti, atëherë aplikanti është i detyruar me shpenzimet e tij të riparojë pjesën e dëmtuar ose jo funksionale deri sa skema e plotë të funksionojë normalisht.

l) Operatori i Sistemit të Shpërndarjes regjistron aplikantin/përdoruesin në sistemin e tij të klientëve dhe përgatit kartelën e furnizimit të tij brenda 2 ditëve pune pas vënies nën tension.

Nëse në propozimin dhe marrëveshjen e lidhjes së re është parashikuar lidhja e energjisë në tensionin e mesëm dhe aplikanti pranon propozimin atëherë:

a) Aplikanti dorëzon tek Operatori i Sistemit të Shpërndarjes formularin e pranimi të propozimit dhe marrëveshjen e lidhjes së re të nënshkruar.

b) OSSH-ja zbaton të gjithë procedurat e parashikuara në këtë rregullore.

c) Brenda 2 ditëve pune nga kryerja e pagesës, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes do të përgatisë urdhrin administrativ për fillimin e projektit në përputhje me kërkesat dhe kushtet teknike të paraqitura në marrëveshjen e lidhjes.

d) Pas dorëzimit të projektit të detajuar të objektit, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes duhet të analizoje atë dhe nëse projekti është në përputhje me kushtet teknike, brenda 2 ditëve pune Operatori i Sistemit të Shpërndarjes do të miratojë projektin dhe njoftojë aplikantin për të kryer të plotë pagesën e tarifës për lidhjen e re. Nëse aplikanti nuk kryen pagesën e tarifës brenda 5 ditëve pune prej momentit të miratimit dhe njoftimit të tij prej Operatorit të Shpërndarjes të mënyrës së lidhjes së tij në tensionin e mesëm të rrjetit shpërndarës, atëherë aplikimi dhe marrëveshja e lidhjes së re do të konsiderohen të pavlefshme dhe ai duhet të aplikojë përsëri për lidhje të re.

e) Pas pagesës së tarifës së lidhjes së re nga ana e aplikantit, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes zbaton të gjitha procedurat për fillimin e punimeve nga Aplikanti.

f) Me fillimin e punimeve, aplikanti duhet të njoftojë OSSH-në, në mënyrë që ky i fundit të marrë masa për fillimin e procesit të mbikëqyrjes, i cili kryhet nga OSSH.

g) Në rastet kur kabina elektrike si pasuri e paluajtshme është ndërtuar nga aplikanti brenda objektit ose godinës e/i cili/a do të furnizohet me energji, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, do të japë aprovimin që ambienti i përshtatur për kabinë, është brenda kushteve teknike dhe e aksesueshme nga ta.

h) Pas përfundimit të punimeve, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes merr masa për kryerjen e kolaudit përfundimtar dhe nëse punimet janë kryer në përputhje me kushtet teknike, atëherë brenda 2 ditëve pune Operatori i Sistemit të Shpërndarjes do të kryejë pranimin dhe lejojë vendosjen e instalimit të sistemit të matjes sipas urdhrit të punës. Nëse gjatë kontrollit konstatohen të meta teknike, atëherë aplikanti

është i detyruar të përfundojë apo korrigjojë të metat e konstatuara.

i) Pas përfundimit të instalimeve dhe pas marrjes në dorëzim të kabinës elektrike, brenda 1 dite pune Operatori i Sistemit të Shpërndarjes përgatit raportin e vendosjes së sistemit të matjes (matësa, bokse kolektive etj.) së energjisë elektrike, i cili duhet të instalohet brenda 5 ditëve pune nga dita e nxjerrjes së raportit të matjes.

j) Verifikimi i matësit të energjisë elektrike realizohet nga subjekti i pavarur, i autorizuar për verifikimin e matësve të energjisë elektrike, sipas parashikimeve të bëra në ligjin nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike". Test raporti i verifikimit të matësit elektrik, dorëzohet nga subjekti i pavarur te klienti dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes.

k) Pas vendosjes së sistemit të matjes, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes përgatit urdhrin e vënies nën tension të pajisjeve. Prova dhe vënia nën tension e pajisjeve do të kryhet brenda 3 ditëve pune dhe do të kryhet nga strukturat përgjegjëse të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes.

l) Në rast se gjatë vënies në tension të objektit lindin probleme në pajisjet që realizuan lidhjen, atëherë aplikanti është i detyruar me shpenzimet e tij të riparojë pjesën e dëmtuar ose jofunksionale, deri sa skema e plotë të funksionojë normalisht.

m) Operatori i Sistemit të Shpërndarjes regjistron aplikantin/klientin apo përdoruesin në sistemin e tij të klientëve dhe përgatit kartelën e furnizimit të tij/tyre brenda 5 ditëve pune pas vënies nën tension. Operatori i Sistemit vë në dispozicion të aplikantit/klientit informacionin e nevojshëm për lidhjen e re ose modifikimin e lidhjes së kryer.

n) Afatet e realizimit të lidhjes së re do të jenë 60 ditë pune të ndara sipas hapave:

Jo më shumë se 25 ditë pune për procedurën e aplikimit tek Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, kontrollin e aplikimit nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, identifikimin e pikës së lidhjes, përgatitjen e dizajnit dhe llogaritjen e shpenzimeve.

- Jo më shumë se 30 ditë pune për marrjen e lejeve përkatëse dhe realizimin e të gjitha punimeve ndërtimore, që do të kryhen nga aplikanti.

- Jo më shumë se 5 ditë pune për instalimin e sistemit të matjes.

3.1.4 Procedurat dhe afatet kohore për lidhje të re ose për modifikim të një lidhjeje ekzistuese në tension të mesëm TM.

a) Përdoruesi apo Aplikanti duhet të paraqesë projektin elektrik të objektit që kërkohet të furnizohet me energji elektrike. Ky projekt duhet të jetë në përputhje me legjislacionin në fuqi, të ketë/të pasqyrojë të gjitha detajet konstruktive dhe mënyrën e realizimit të instalimeve të brendshme të tij duke u shoqëruar me relacionin teknik përkatës për të treguar të gjitha ngarkesat elektrike dhe mënyrën e vendosjes së tyre brenda objektit. Projekti duhet të respektojë kushtet teknike të lidhjes së re, të cilat janë pjesë e kësaj rregullore. Ky projekt duhet të jetë i realizuar dhe përllëguar nga një inxhinier i licencuar ose kompani e licencuar për projekte elektrike.

b) Operatori i Sistemit të Shpërndarjes do të kryejë paraprakisht verifikimin e dokumentacionit të paraqitur nga përdoruesi apo aplikanti dhe nëse aplikimi nuk është i plotë, atëherë Operatori i Sistemit të Shpërndarjes do të njoftojë përdoruesin apo aplikantin me shkrim brenda 5 ditëve pune që nga data kur aplikimi është dorëzuar për vlerësim.

c) Operatori i Sistemit të Shpërndarjes do të inspektojë objektin që kërkon lidhjen me energji elektrike dhe në varësi të gjendjes së rrjetit elektrik në atë zonë, do të hartojë studimin e fizibilitetit, do të përgatisë propozimin dhe marrëveshjen për lidhjen e re dhe do t'ia dërgojë aplikantit për pranim sipas afateve.

d) Propozimi për lidhjen e re, i përgatitur nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes mund të pranohet nga aplikanti jo më vonë se 5 (pesë) ditë pune nga data që Operatori i Sistemit të Shpërndarjes e ka vendosur propozimin e tij në dispozicion të aplikantit.

e) Nëse aplikanti e pranon propozimin, atëherë dorëzon formularin e pranimi të ofertës, nënshkruan aktmarrëveshjen dhe paguan detyrimet përkatëse brenda 5 ditëve pune nga njoftimi i propozimit të bërë, përndryshe propozimi bëhet i pavlefshëm dhe ai duhet të aplikojë përsëri për lidhje të re.

f) Pas pagesës së tarifës së lidhjes së re nga ana e aplikantit, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes zbaton të gjitha procedurat për fillimin e punimeve. Punimet do të kryhen nga operatori i licencuar nga organet kompetente, i zgjedhur nga aplikanti për realizimin e lidhjes së re.

g) Me fillimin e punimeve, aplikanti duhet të njoftojë OSSH-në, në mënyrë që ky i fundit të marrë masa për fillimin e procesit të mbikëqyrjes, i cili kryhet nga OSSH-ja.

